



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr. 31/1 Prot.

Tiranë, më 23.01.2020

VENDIM

KËSHILLI KOORDINUES I BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Nr 2 datë 23.01.2020

Këshilli Koordinues i Qendrës së Botimeve për Diasporën, në mbështetje të ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 për “*Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, VKM nr.469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”,

VENDOSI:

1. Miratimin e krijimit të Platformës online për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë;
2. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën

PIRO MISHA

Anëtarë

Znj. Etleva Kondi

Znj. Mira Hoxha

Znj. Anila Ferizaj

Znj. Floresha Dado



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

KONCEPT IDE

Titulli i projektit: Platforma online e mësimdhënies së gjuhës shqipe



Aplikanti	Qendra e Botimeve për Diasporën
Titulli i propozimit	Platforma online e mësimdhënies së gjuhës shqipe
Identifikimi i problemit (analiza e situatës dhe përshkrimi i ndërhyrjes)	<p>Bazuar në VKM-në Nr. 240, datë 21.03.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020 për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”: shkronjat a) dhe b), pika 6/1 e VKM Nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.</p> <p>Duke vlerësuar situatën e emergjencës së krijuar, QBD-ja gjykon të domosdoshme rishtikimin e projekteve vjetore, duke nxjerrë në plan të parë krijimin e një platforme digjitale për mësimin e gjuhës shqipe që do të mundësojë ofrimin e mësimdhënies në distancë për të gjithë fëmijët në diasporë, të interesuar për mësimin e gjuhës shqipe.</p> <p>Platforma online (web & mobile) e mësimdhënies së gjuhës shqipe do t’i vijë në ndihmë mësuesve, me fokus mësuesit në Diasporë që të mund të krijojnë klasat virtuale me nxënës të diasporës shqiptare, por dhe me nxënës të huaj që dëshirojnë të mësojnë gjuhën shqipe.</p>
Qëllimet dhe objektivat	<p>Platforma digjitale synon të realizojë aksesin në mësimin e gjuhës shqipe nga të gjithë nxënësit në diasporë duke kapërcyer të gjitha vështirësitë që paraqet situata e mësimdhënies fizike sot në gati të gjitha vendet e botës.</p> <p>Platforma do të ofrojë komunikim live dhe ndërveprim live midis mësuesit dhe nxënësve, por edhe ndërveprim midis vetë nxënësve si në një orë mësimi normale.</p>

<p>Metodologjia</p>	<p>Platforma do të jetë organizuar si një faqe web ku përdoruesit që do të futen në sistem do të jenë të ndarë në dy grupeve, mësues dhe nxënës. Në bazë të grupit ku bëjnë pjesë përdoruesit do të marrin të drejta për të aksesuar në sistem.</p> <p>Platforma do të ketë një organizim të tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesit do të ketë vetëm akses te klasat dhe nxënësit e tij virtuale; - Nxënësit do të kenë akses te klasat virtuale ku bëjnë pjesë; - Administratorët e sistemit do të kenë akses të plotë në sistem dhe do të bëjnë modifikimet e kërkuara nga nxënësit dhe mësuesit (kur kjo i shërben përmirësimit të mëtejshëm të platformës).
<p>Aktivitetet kryesore</p>	<p>Ndarje në klasa/lëndë për të bërë të mundur aksesimin e shpejtë të faqes; Ndarje të klasave sipas cikleve (klasat e mësimit të gjuhës shqipe do të jenë të ndara për ciklin e ulët dhe atë të lartë).</p> <p>Krijimi i një menuje me emërtimin Forum, ku nxënësit/mësuesit mund të diskutojnë për tematika të ndryshme që lidhen me mbarëvajtjen e mësimdhënies online.</p>
<p>Rezultatet e pritura kryesore</p>	<p>Vendosja e komunikimit mes nxënësve dhe mësuesve në të gjitha kurset dhe shkollat e gjuhës shqipe në diasporë.</p> <p>Komunikimi i drejtpërdrejtë dhe bashkëveprim midis mësuesve dhe nxënësve, por edhe ndërveprim ndërmjet vetë nxënësve.</p>
<p>Përfituesit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komuniteti shqiptar vendas dhe ai i Diasporës. - Nxënës dhe mësues në Diasporë
<p>Vazhdimësia</p>	<p>Synohet bashkëpunimi me partnerë të tjerë dhe donatorë, të cilët do të mbështesin këtë platformë mësimdhënie, për të mbuluar koston dhe ofrimin e shërbimit.</p>
<p>Shuma në lekë</p>	<p>2.000.000 lekë (Platforma)</p> <p>2.000.000 lekë (Grupi hartues dhe zbatues i specialistëve)</p>
<p>Kohëzgjatja e projektit</p>	<p>8 muaj: (nga data 1 maj deri më 30 nëntor)</p>
<p>Zona e Zbatimit</p>	<p>Shqipëri dhe Diasporë</p>

<p>Grupi i punës</p>	<ul style="list-style-type: none"> - QBD - Akshi (për hartimin e termave të referencës, përcaktimin e fondit limit dhe nxjerrjen e operatorit fitues). - Një grup pune me specialistë të fushës së mësimdhënies së gjuhës shqipe, hartues të teksteve shkollore, mësues në diasporë. <p>Grupi i punës do të përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfaqësues nga Departamenti i Gjuhësisë, në Universitetin e Tiranës; Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Durrësit, etj. 2. Përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar); 3. Mësues të diasporës etj.
<p>Partner(ët)</p>	<p>Universitet, shkollat publike dhe private shqiptare dhe në Diasporë.</p>